



angazhohet që...

- interesat dhe nevojat e njerëzve me prapavijë migrimi të dëgohen nga politika dhe të merren para sysh
- njerëzit nga kultura dhe religjione të ndryshme të kontaktojnë njëri me tjetrin, të zhvillojnë interesim për njëri tjetrin dhe të zbulojnë vlera të përbashkëta
- gjuha amtare dhe identiteti i dyfishtë kulturor të shikohet si pasuri dhe të mësohet te vlerësohet si e tillë
- të emigruarit të gjejnë sa më parë kyçje në shkollim profesional dhe tregun e punës
- diskriminimi, përjashtimi shoqëror dhe racizmi në Velbert nuk do të tolerohen dhe nuk do të pranohen

Veproni edhe ju!

Siguroje ardhmërinë e Këshillit të Integrimit në Velbert!

Shko më 13.09.2020, voto dhe jepe votën tënde!

Vota jote është e rëndësishme!

Zgjedhjet e Këshillit të Integrit të qytetit Velbert më 13.09.2020

Më 13.09.2020 do të zgjidhet Këshilli i Integrit të qytetit Velbert.

Këshilli i Integrit përbëhet nga anëtarë të zgjedhur dhe anëtarë të Kuvendit Komunal të cilët dërgohen së bashku në Forumin e Kuvendit Komunal. Këshilli i Integrit është përfaqësimi komunal i të gjithë velbertaseve dhe velbertasve me prapavijë migrimi (*me prejardhje migracioni*).

Anëtarët e tij e bashkësojnë në mënyrë aktive politikën e integrit dhe punën e integrit. Ata....

- ... komunikojnë së bashku me institucionet dhe strukturat e administratës së qytetit interesat dhe çështjet e të emigruarve në Velbert,
- ... marrin pjesë në punën e komosioneve qarqeve të punës dhe kanë një funksion këshillëdhënës dhe
- ... përkrahin planifikimin dhe zbatimin e manifestimeve dhe projekteve të ndryshme.

Forumi zgjidhet çdo 5 vite.

Votojnë dhe kështu mund të vendosin mbi përmbajtjen e Forumit:

- **Persona që nuk posedojnë pasaportë gjermane,**
- **Njerëz pa shtetësi,**
- **Gjermanë, të cilët përveç pasaportës gjermane posedojnë edhe një pasaportë të huaj,**
- **Njerëz që kanë marrë shtetësi Gjermane, (të natyralizuarit),**
- **Fëmijë të lindur në Gjermani që i kanë prindërit të huaj,**
- **Qytetarë jogjermanë të Bashkimit Evropian dhe**
- **Anëtarë të kolonëve të riatdhesuar në Gjermani**

nëse ju më 13.09.2020 i mbushni 16 vjet, qëndroni së paku një vit në Gjermani me leje të rregullt juridike dhe së paku nga data 28.08.2020 banesën kryesore e keni në Velbert.

Të gjithë banorët që kanë të drejtë vote, do të marrin nga Qyteti Velbert deri më 23.08.2020 një letër me anë të postes dhe do të informohen mbi zgjedhjet.

Zgjedhjet e Këshillit të Integrit do të mbahen më 13.09.2020 së bashku me zgjedhjet komunale në të gjithë **vendvotimet!**

Anëtarët që mund të votohen gjinden në 4 Lista:

- 1. Internationale Sozialdemokratische Liste (ISDL)**
- 2. Vielfalt in Velbert (ViV)**
- 3. Velberter Internationale Liste (VIL)**
- 4. Kurdisch Demokratische Liste (KDL)**

Informata në hollësi mbi përmbajtjen e çdo liste në veçanti ju lusim ti nxirrni nga Gazeta Zyrtare Nr. 27/2020 të datës 03.08.2020 nga faqja e internetit e Qytetit Velbert.

Votën tuaj mund t'ia jepni vetëm njërës nga 4-Listat.

**Shfrytëzojeni votën tuaj
dhe merrni pjesë në sajimin e politikës së integrit në Velbert!**